



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	10.05.2024
REFERENC-Ë:	23/6194/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"KORAL DAIRY" Sh.p.k Fushë Kosovë Fabrikë për Prodhimin e Produkteve nga Qumështi
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Ab
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore


Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit, "KORAL DAIRY" Sh.p.k, Fushë Kosovë, me nr. prot. 23/6194/MMPHI.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

- Vendimi për Leje Mjedisore për operatorin, "KORAL DAIRY" Sh.p.k Fushë Kosovë, Fabrikë për Prodhimin e Produkteve nga Qumështi

Me respekt!



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

Nr.: 23/6194/MMPHI  
Datë: 10.05.2024

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe neni 9 paragrafi 1.4 i Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

## V E N D I M

1. Operatori "KORAL DAIRY" Sh.p.k Fushë Kosovë, **pajiset me Leje Mjedisore** për veprimtarinë: Fabrikë për Prodhimin e Produkteve nga Qumështi në ngastren nr. 2438-1 dhe nr.2439-1, zona kadastrale, Fushë Kosovë.
2. Operatori obligohet:
  - 2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
  - 2.2. Vlerat e cilësisë së ajrit të jenë në nivelin e lejuar sipas legjislacionit në fuqi;
  - 2.3. Raporti i rezultateve të emisioneve në ajër, sipas dinamikës së përcaktuar me legjislacion, të i dorëzohet MMPHI-së;
  - 2.4. Të respektohen kushtet e përcaktuara me Lejet Ujore për shfrytëzim dhe shkarkim të ujit dhe të avancohet impianti për trajtimin e ujërave;

- 2.5. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI-në;
- 2.6. Për sistemin menaxhues mjedisor të ketë personin e profilit mjedisor që është përgjegjës për mjedis;
- 2.7. Për zgjerim te kapacitetit dhe ndryshim te veprimtarisë, operatori obligohet te njoftoj MMPHI-ne.
- 2.8. Afati i lejes Mjedisore është për periudhën 5 (pesë) vjeçare nga dita e lëshimit te këtij vendimi.

## A r s y e t i m

Është shqyrtuar kërkesa për Leje Mjedisore për operatorin: "KORAL DAIRY" Sh.p.k Fushë Kosovë, Fabrikë për Prodhimin e Produkteve nga Qumështit, në ngastrat nr. 2438-1 dhe nr.2439-1, zona kadastrale, Fushë Kosovë.

Operatori ka bashkangjitur dokumentacionin:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr.13/99, të dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Pëlqim Mjedisor me Nr.13/478/1-64/DMM, të datës 11.04.2013;
- Leje Ujore për Shfrytëzim te Ujit me Nr.3318-3/14-ZSP-454, dt.06.10.2023;
- Leje Ujore për Shkarkim te Ujit me Nr.132/16-ZSP-410, dt. 06.10.2023;
- Raporti i analizave të emisioneve në ajër, Nr.109, dt.15.04.2024, nga Instituti "INKOS";
- Aktvendim nga Drejtoria për Planifikim Urban-Leje Legalizim dhe Leje Përdorimi Komuna, Fushë Kosovë, me nr.290, datës:17.06.2016;
- Pëlqimin nga AME, nr.155/11 me datë: 29.10.2010

Duke u bazuar ne dokumentacionin e dorëzuar dhe plotësuar nga pala dhe gjendjes faktike nga shikimi ne vend me zyrtaret profesional, sipas legjislacionit në fuqi për mjedisin dhe Udhëzimit Administrativ të MMPHI- se Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore janë paraqitur kushtet si në dispozitiv.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori i plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore.

Kjo Leje Mjedisore lëshohet për periudhën 5 (pesë) vjeçare, në përputhje me nenin 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i 'dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Fushë Kosovë;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.